2.5.	Anëtar i Komisionit qendror për regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve (2016, 2017, 2018, 2019, 2020).	1x5=5
2.6.	Anëtar i Komisionit qendror për regjistrimin e studentëve në ciklin e tretë të studimeve (2016, 2017, 2018, 2019, 2020).	1x5=5
3.	Funksion në fakultet	11
3.1.	Koordinator për ECTS në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës.	3
3.2.	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit(2016, 2017, 2018, 2019, 2020).	1x5=5
3.3.	Anëtar i Komisionit për përgatitjen e programit studimor të ciklit të parë (2019).	1
3.4.	Anëtar i Komisionit për përgatitjen e programit studimor të ciklit të dytë (2020).	1
3.5.	Anëtar i Komisionit për përgatitjen e programit studimor të ciklit të tretë (2020).	1
4.	Anëtarësia në trupa profesionale	1
4.1.	Anëtar i <i>Grupit Operativ Punues për Kodifikimin e së Drejtës dhe Rendit Juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut</i> , Ministria e Drejtësisë (2020 - vazhdon).	1
5.	Redakturë dhe korrekturë	4
5.1.	Korrektor i librit <i>E drejta dhe administrata publike</i> , të autorëve: Fejzulla Berisha, Jusuf Zejneli, Argëtim Saliu, Shkup, 2020.	2
5.2.	Korrektor i librit <i>E drejta administrative</i> , të autorëve: Fejzulla Berisha, Jusuf Zejneli, Argëtim Saliu, Shkup, 2019.	2

6.	Trajnime	2
6.1.	Punëtorja: <i>Application of Statistical Methods in Research</i> , Universiteti i Tetovës, 15-16 nëntor, 2019.	1
6.2.	International Symposium of Scientific Journals of Trakya University: <i>How to Become Successful Authors & Editors of Scientific Journals</i> , Trakya University, 4-6 dhjetor, 2018.	1
	GJITHSEJ	53

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN	Pikët
PROFESOR INORDINAR	
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	192.77
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	63.2
VEPRIMTARITË NË INTERES TË GJERË	53
GJITHSEJ	308.97

Tetovë, 23.12. 2020

KOMISIONI RECENSUES:

1. Prof. Dr. Osman Kadriu - kryetar

2. Prof. Dr. Bashkim Selmani - anëtar

3. Prof. Dr. Brikend Aziri - anëtar

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE - RIZGJEDHJE TË NJË
MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE - SHKENCORE NË
FAKULTETIN JURIDIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në bazë të konkursit për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësve në Universitetin e Tetovës të datës 08.12.2020, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Sloboden Peçat” dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndë mësimore në fushën e shkencave politike në kuadër të Fakultetit Juridik, konkretisht për lëndët:

- 1. Hyrje në shkencat politike, dhe**
- 2. Analiza e politikës së jashtme**

me propozim të Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Juridik numër **13-1316/1** të datës **21.12.2020** është formuar Komisioni Recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Ylber Sela, profesor ordinar - kryetar,**
- 2. Prof. Dr. Mersim Maksuti, profesor ordinar - anëtar,**
- 3. Prof. Dr. Bashkim Selmani, profesor ordinar - anëtar.**

Komisioni Recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 132 të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” numër 82/2018), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës këtë:

RAPORT RECENZUES

Në konkursin e datës **08.12.2020**, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Sloboden Peçat” dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore:

- 1. Hyrje në shkencat politike, dhe**
- 2. Analiza e politikës së jashtme**

në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, u paraqit kandidati:

- Doc. Dr. Shefik Shehu

Komisioni Recensues ka nderin të paraqesë këtë:

R E F E R A T

I. Të dhënat biografike, përgatitja profesionale-shkencore dhe aktiviteti pedagogjik

Shefik Mushteba Shehu u lind më 06.08.1978 në Strugë. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje. Shkollimin e mesëm e kreu në Shkup, në medresenë Isa Beu. Në vitin 1998 i regjistroi studimet deridiplomike në Universitetin Ndërkombëtar të Malajzisë, në Kuala Lumpur, në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe u diplomua në vitin 2002 me *arritje të veçanta* (mesatarja e arritur 9.5).

Në vitin 2007 përfundoi studimet e ciklit të dytë të magistraturës në *Institutin për kërkime dhe hulumtime në marrëdhënie ndërkombëtare dhe evropiane* në Hungari, me temë "*Marrëveshja e Ohrit: Rruga drejt integritit apo shpërbërjes*".

Ndërkaq studimet e doktoraturës i regjistroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit Shën Kirili dhe Metodi, në Institutin për studime të mbrojtjes dhe të paqes. Në korrik të vitit 2015, fitoi gradën *Doktor i shkencave të sigurisë*, duke mbrojtur me sukses temën: "*Maqedonia dhe Strategjia e Sigurisë Evropiane: Roli i Maqedonisë në sigurinë e Bashkimit Evropian*".

Pas përfundimit të studimeve dhe kthimit në Maqedoni, ka punuar në një sërë organizmash ndërkombëtare, që prekin fushën e konsolidimit politik të vendit, përfshirë këtu *Fondacionin Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES)*, *Mercy Corps International*, *EU CARDS programin* dhe për një periudhë 5 vjeçare në Agjencionin Ndërkombëtar për Zhvillim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës-USAID, në cilësinë e koordinatorit rajonal.

Në shkurt të vitit 2008, Shefik M. Shehu u punësua në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Zyrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare, në cilësinë e zhvilluesit të projekteve dhe paralelisht i angazhuar edhe si asistent në Fakultetin Juridik. Pas aplikimit të suksesshëm në Programin TEMPUS, Dr. Shehu inicoi themelimin e Qendrës për Shërbime Studentore dhe Karrierë, dhe të njëjtën e mëkëmbi deri në etablimin dhe profilizimin e plotë të saj, në funksionin e një pjese integrale të shërbimit studentor të Universitetit. Nga shtatori i vitit 2009, emërohet udhëheqës i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare, të cilën e drejton deri në vitin 2011, kur kalon në udhëheqjen e Zyrës për Arsim.

Përgjatë këtyre pozicioneve, z. Shehu paraqitet edhe në rolin e koordinatorit lokal të disa projekteve TEMPUS, me institucione bartëse eminente si Universiteti i Kolegjit të Dablnit, Universiteti i Geteburgut, Universiteti i Redingut, Universiteti i Wageningenit, etj. Në këtë cilësi, Dr. Shehu ka qenë pjesë kyçe e përpilimit të disa planprogrameve studimore të ciklit të parë, të dytë dhe studimeve të specializimit,

programe këto që kanë lehtësuar rrugën e institucionalizimit të partneriteteve për Universitetin e Tetovës, me aktivitete dhe projekte tjera.

Roli dhe kontributi i z. Shehut vërehet edhe në udhëheqjen e programit të ciklit të dytë, në Fakultetin Juridik, atë të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, moduli i të Drejtave të Njeriut, që ofrohej vetëm në gjuhën angleze. Dr. Shehu po ashtu ka kontribuar në përpilimin e programit studimor të Shkencave Politike, program ky që fitoi akreditimin që të realizohej edhe në gjuhën angleze, i pari i këtij lloji në Universitetin e Tetovës, i cili për herë të parë u bë pjesë e gamës së programeve studimore të Universitetit të Tetovës në vitin 2012.

Nga viti 2017, u emërua përgjegjës i Zyrës për Përpilimin dhe Menaxhimin e Projekteve, në të cilën u shënuan një sërë aplikimesh dhe pjesëmarrje të Universitetit të Tetovës në një numër të konsiderueshëm të programeve.

Në këtë periudhë Universiteti i Tetovës e shumëfishon pjesëmarrjen në rrjetin hulumtues CEEPUS dhe tashmë stafi akademik i më shumë se gjashtë (6) fakulteteve merr pjesë në 10 rrjete këmbimi, nga radiologjia e deri te hortikultura, me partnerë solid nga vendi, rajoni dhe Evropa Qendrore. Po nga ky pozicion, nisi trajnimet e njëpasnjëshme të koordinatorëve për projekte nga secili fakultet, duke synuar kështu ngritjen e kapaciteteve profesionale brenda fakulteteve për përfshirjen e njësisive universitare në projekte hulumtuese, zhvillimore e shkencore ndërkombëtare.

Ngjashëm, kandidati Shehu u përqendrua në finalizimin dhe auditimin e projekteve ekzistuese nga platforma IPA, UNEP si dhe ato Erasmus+. Përqendrim dhe kohë e veçantë u nda për të rritur pjesëmarrjen e Universitetit në platformën Erasmus+ duke iniciuar bashkëpunim me institucione simotra nga mbarë rajoni si dhe vendet e programit. Këto përpjekje rezultuan në përfshirjen e UT-së në njërin nga 17 aleancat universitare që u inauguruan nga Bashkimi Evropian në vitin 2019. Tashmë Universiteti i Tetovës është pjesë e AURORA Alliance, krahas universiteteve prestigjioze siç janë:

Vrije Universiteit Amsterdam
University of Iceland
Copenhagen Business School
University of East Anglia
Univerzita Palackého v Olomouci

Vlen të theksohet angazhimi në fushën e këmbimit të stafit akademik me institucione relevante akademike nga SHBA në kuadër të programit Fullbright, si dhe ripërtirja e bashkëpunimit me Peace Corps. Aplikimet për prezencën e vullnetarëve nga Korpusi i Paqes së SHBA-ve në Universitetin e Tetovës rezultoi me ardhjen e z. Erik Rodriguez në Zyrën për Përpilim dhe Menaxhim me Projekte. Ngjashëm, aplikimi për angazhimin e një eksperti nga programi prestigjioz Fullbright Senior Specialist rezultoi me ardhjen e profesoreshës Janet Schofield. Profesoresha Schofield bëri një

vlerësim të tërthortë të politikave hulumtuese, strategjisë së avancimit shkencor si dhe rekomandime kyçe mbi hapërimin e Universitetit të Tetovës drejt konsolidimit të komponentës shkencore. Raporti i saj tashmë na shërben si një hartë veprimi për udhëheqësinë e Universitetit në këtë fushë.

Në vitin 2019 u emërua në postin e Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, prej kur edhe shënohen aktivitete të ndryshme në fushën e promovimit të Universitetit në qarqet akademike ndërkombëtare, me theks të veçantë intesifikimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit me EUA si dhe aplikimi nëpër rrjete të ndryshme akademike ndërkombëtare.

Nga aktivitetet e kandidatit Shehu, për vitin 2020, në cilësinë e Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar mund të veçojmë:

- aplikimi për anëtarësim të plotë në EUA
- aplikimi për anëtarësim në International University Association (IAU)
- zgjerimi i partnerëve universitarë nga vendet e Bashkimit Evropian (katër Memorandume Bashkëpunimi)
- konsolidimi i bashkëpunimit me universitetet shqiptare (dy marrëveshje të reja)
- kontaktet e vazhdueshme me Agjencionin kombëtar për programet arsimore evropiane dhe mobilitet (dyfishimi i mjeteve për KA1 për vitin akademik 2020/2021)
- zgjerimi i marrëveshjeve ndër-institucionale në kuadër të platformës Erasmus+ (15 marrëveshje të reja gjatë vitit 2020)
- organizimi dhe promovimi i konkurseve Erasmus me studentët dhe stafin akademik
- përfaqësues universitar në konferenca, vebinare, ngjarje dhe manifestime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit

- ***Thirrjet paraprake***

- Në vitin 2011, z. Shehu u zgjodh bashkëpunëtor i rregullt në Fakultetin Juridik, në katedrën e Studimeve Politike, për lëndët:
 1. *Hyrje në shkencat politike,*
 2. *Sistemet politike,*
 3. *Partitë politike dhe grupet e interesit dhe*
 4. *Politika dhe mediumet.*
- Ndërsa në vitin 2016, u zgjodh *Docent* për lëndët:
 1. *Hyrje në shkencat politike, dhe*
 2. *Analiza e politikës së jashtme*

II. Punimet e publikuara të kandidatit

Doc. Dr. Shefik Shehu është i pranishëm në shumë aktivitete hulumtuese dhe trajtesa shkencore. Fushat e interesit të z. Shehut, përfshijnë një plan më të gjere të lëmit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Vlen të theksohet përfshirja e tij në projektet hulumtuese ndërkombëtare:

1. *Peace Education's impact on relationship building and societal conflicts*, finansuar nga Këshilli për hulumtim i Suedisë, 2014-2016
2. COST projekti: CA17119: *EU Foreign Policy Facing New Realities: Perceptions, Contestation, Communication and Relations* (anëtar nga RMV) 2019-vijon
3. *Hate speech during the campaign of the 2020 parliamentary elections in the RNM: perceived effects on the behaviour of citizens in intergroup relations*, UT 2020
4. Koordinator universitar në rrjetin CEPUS: CZ-0311 (2018-vijon)

Ndërkaq, puna e tij hulumtuese-shkencore reflektohet me botimet në vijim:

1. Fehari Ramadani & **Shefik Shehu**: Shqipëria e viteve 1901-1905 në sytë e Konsullit Kral (Promermorie mbi Shqipërinë nga fundi i vitit 1901 deri në fillim të vitit 1905), botuar në *Përmbledhje punimesh të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare 'Marrëdhëniet e Popullit Shqiptar me Austro-Hungarinë (Austrinë) nga mesi i shekullit XIX deri në ditët tona'*, Shkup-Prishtinë, 2017
2. Kushtrim Ahmeti & **Shefik Shehu**: The Ranking of Higher education institutions in the Republic of North Macedonia-A Mechanism for increasing the quality of education or the violation/restriction of university autonomy?, published in 5th Annual Conference of the Balkan Universities Association *Working Papers, Aristotle University of Thessaloniki, April 2019*
3. **Shefik Shehu**: Democracy Promotion: The Cornerstone of America's Foreign Policy after the Cold War, *Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication, Volume 1, Issue 1/2, pp.26-30*
4. **Shefik Shehu** & Gjeraqina Leka: Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach, *Justicia, Vol. 8, pp.199-206*
5. Vullnet Ameti, Sheruze Osmani Ballazhi, **Shefik Shehu** & Vjollca Memishi Fejza: The Role of Food Processing Company Employers in Increasing Quality in Higher Education, *International Journal of Food Technology and Nutrition, Vol.3, No. 5/6, pp.9-14*
6. **Shefik Shehu** & Gjeraqina Leka: Gjuha e urrejtjes: një pasqyrim normativ (në botim), Botim i veçantë në kuadër të projektit hulumtues: Hate speech during the campaign of the 2020 parliamentary elections in the RNM: perceived effects

on the behaviour of citizens in intergroup relations, Universiteti i Tetovës, 2020

Doc. Dr. Shefik Shehu është paraqitur me kumtesa edhe në disa konferenca me karakter ndërkombëtar të organizuara në Maqedoni dhe jashtë saj. Do të veçojmë, me sa vijon:

1. **The Euro-Atlantic Values in the Balkan Countries**, pjesëmarrës, organizuar nga Fakulteti për siguri, Universiteti Kliment Ohridski, Ohër-23 shtator 2020
2. **The Ranking of Higher Education Institutions in the Republic of North Macedonia-a mechanism for increasing the quality of education or the violation/restriction of University autonomy**, prezantuar në: 5th Annual Conference of the Balkan Universities Association-UN 2030 Sustainable Development Goals in the Balkan Region-the Role of the Universities, Aristotle University of Thessaloniki, 16-18 prill, 2019 Selanik, Greqi
3. **A New Defense Pact for Europe**, prezantuar në konferencën 2nd Annual International Conference *Global Problems & Community Praxis: Local, National, and International Approaches to Peace and Transcultural Communication*, April 19, 2018 Northern Illinois University, Çikago, SHBA
4. **PESCO and the future of EU security**, prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare: The Balkans in the European Integration - Past, Present and Future, Universiteti i Sofjes Shën Kliment Ohridski, 16-18 maj 2018, Sofje, Bullgari
5. **Marshall Center Alumni Security Forum**; Ohër, Maqedonia e Veriut (panelist në sesionin *Republic of North Macedonia and Euro-Atlantic Integrations: Failures, Achievements and Perspectives*) 24-26 gusht 2019, Ohër
6. **Marshall Center Security Forum Transnational Security Threats: Regional and National Contribution to the Regional Security**; Ohër, Maqedonia e Veriut (panelist në sesionin: Euro-Atlantic Response to Emerging Security Threats: Common Transatlantic Response to Diverse Transnational Threats) 17-21 shtator 2018, Ohër
7. **Bologna Process Anniversary**, University of Bologna, Italy, 24-25 qershor 2019
8. **Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach**, prezantuar në: 6th International Scientific Conference of Law "European Perspective of the Western Balkans", Universiteti i Tetovës, 13-15 nëntor 2019
9. **Shqipëria në sytë e Konsullit Kral 1901-1905**, prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Marrëdhënia e Shqiptareve me Austro-Hungarinë (Austrinë) nga mesi i shekullit XIX deri në ditët tona, UBT, 9 shtator 2016, Prishtinë, Kosovë

10. **Democracy Promotion: The Cornerstone of America's Foreign Policy After the Cold War** prezantuar në The Impact of US Policy in Promoting Democracy, Peace, State-Building, Economic Recovery and the Protection of National, Religious and Civic Values in the Countries of the Region, Universiteti i Tetovës & Northern Illinois University, 15 dhjetor 2016
11. **The Strategic Culture of the European Union: From the European Security Strategy to the Global Strategy of the EU**, prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore The Law and Challenges of the Euro-Atlantic Processes, Faculty of Law, Universiteti i Tetovës, 18-19 nëntor 2016, Tetovë
12. **The European Union's security nexus: A constructivist approach**, prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Universality, Globalization and the Rule of Law, Universiteti i Tetovës, 13-14 nëntor 2015, Tetovë
13. **Turkish Foreign Policy Under the Justice and Development Party's Rule**, prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process, Universiteti i Tetovës, 17-18 nëntor 2017
14. Pjesëmarrës në Konferencën **EU Foreign Policy in Times of Populism**, organizuar nga Akademia Diplomatike e Vjenës në kuadër të COST projektit CA17119, Vjenë, Austri

Ndërkohë ka marrë pjesë dhe në shkëmbime akademike dhe vizita studimore. Këtu veçojmë:

- i. **Ludvig Maximilian University, University of Augsburg & University of Regensburg**, Gjermani, 4-10 nëntor 2018, organizuar nga CBC Loja
- ii. Punëtori dhe ligjërata në **Universitetin Peradenija, Kandi, Sri Lankë**, në kuadër të projektit hulamtues Peace Education's impact on relationship building and societal conflicts, finansuar nga Swedish Reserch Council, 1-8 nëntor 2016
- iii. Vizitë pune në **Universitetin Mehmet Akif Ersoj, Burdur, Turqi** 1-3 nëntor 2017
- iv. Këmbim akademik Erasmus +, në **Lithuania Business University of Applied Sciences, Klaipeda, Lituani**, 4-7 shtator 2018
- v. Vizitë pune në **Alexander Technological Educational Institute (ATEI), Selanik, Greqi**, 17 prill 2018

Ndërkaq, në fushën aplikative dhe me interes të përgjithshëm, kandidati Shehu, paraqitet me një angazhim të larmishëm si trajnues në tematikën e *ballafaqimit me të kaluarën*, në një sërë trajnimesh në vend dhe jashtë:

- a) Trajnues në trajnimin “**Teachers of Tomorrow**”, organizuar nga ForumZfD Prishtinë, përmes platformës ZOOM. Moduli i trajnimit: Multiperspektiviteti dhe Kultura e Mbamendjes, 19 nëntor 2020
- b) Trajnues në trajnimin e organizuar nga Komisioni për mundësi të barabarta, Komuna e Strugës, në temë: **Lufta ndaj diskriminimit në një shoqëri demokratike**, 15 nëntor 2019, Strugë
- c) Trajnues në Shkollën Verore **Challenge History** organizuar nga ForumZfD Bosnjë dhe Hercegovinë, 16-21 korrik 2017, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë
- d) Trajnues në trajnimin për trajner për përdorimin e instrumentit pedagogjik mbi kulturën e kujtesës “**MemorInmotion**” (**kujtesa në lëvizje**), organizuar nga ForumZfD Bosnjë dhe Hercegovinë & ForumZfD Prishtinë dhe EUROCLIO HIP BiH, 26 nëntor 2016, Prishtinë
- e) Trajnues në trajnimin për trajnerë për përdorimin e instrumentit pedagogjik mbi kulturën e kujtesës “**MemorInmotion**” (**kujtesa në lëvizje**), organizuar nga ForumZfD Bosnjë dhe Hercegovinë & ForumZfD Prishtinë dhe EUROCLIO HIP BiH, 19-20 Nëntor 2016, Shkup

MENDIM DHE PROPOZIM

Veprimtaria e deritanishme e Doc. Dr. Shefik M. Shehut tregon se ai me shumë sukses ka hapëruar në shkallët e zhvillimit të tij individual dhe profesional duke u ngritur kështu në një profesionist kompetent në fushat për të cilat ai konkurren.

Duke u mbështetur në të dhënat e paraqitura dhe në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, dhe mësimore-profesionale, si dhe thirrjet për bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, Komisioni konstatoi se kandidati Shefik M. Shehu, ka arritur **164.2** pikë, duke tejkalluar kështu bindshëm minimumin e kërkuar për avancim në thirrjen mësimore-shkencore *profesor inordinar*.

Për ne paraqet një nder dhe kënaqësi të veçantë, t'i propozojmë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, që:

Doc. Dr. Shefik M. Shehu të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **PROFESOR INORDINAR** për lëndët: ***Hyrje në shkencat politike*** dhe ***Analiza e politikës së jashtme***.

Tetovë, më 23 dhjetor 2020

Anëtarët e Komisionit Recensues:

Prof. Dr. Ylber Sela (kryetar)

Prof. Dr. Mersim Maksuti (anëtar)

Prof. Dr. Bashkim Selmani (anëtar)

SH T O J C Ë

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Shefik Shehu

Institucioni: Fakulteti Juridik – UT, Tetovë

Lëmi shkencor: Shkenca Politike

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
1.	<i>Mbajtja e ushtrimeve</i> (lëndët në studimet e ciklit të parë)	
1.1.	Hyrje në shkencat politike (Studime Politike), 2 orë (ngarkesa javore), 5 semestra	2*15*5*0.03=4.5
1.2.	Integrimet evropiane , 2 orë (ngarkesa javore) (Studime Politike), 5 semestra	2*15*5*0.03=4.5
1.3	Politika e jashtme e SHBA-së (Shkenca Politike), 1 semestër	2*15*1*0.03=0.9
1.4	Analiza e politikës së jashtme (Studime Politike), 5 semestra	2*15*5*0.03=4.5
1.5	Studime evropiane (Studime Politike), 4 semestra	2*15*4*0.03=3.6
	<i>Mbajtja e ligjëratave</i> (lëndët në studimet e ciklit të parë)	
2.1	Hyrje në shkencat politike (Studime Politike), 3 orë (ngarkesa javore), 5 semestra	3*15*5*0.04=9
2.2	Integrimet evropiane (Studime Politike), 2 orë (ngarkesa javore) 5 semestra	2*15*5*0.04=6
2.3	Politika e jashtme e SHBA-së (Studime Politike), 1 semestër	2*15*1*0.04=1.2
2.4	Analiza e politikës së jashtme (Studime Politike), 5 semestra	2*15*5*0.04=6
2.5	Studime evropiane , (Studime Politike), 4 semestra	2*15*4*0.04=4.8
	<i>Mbajtja e ligjëratave</i> (lëndët në studimet e ciklit të dytë)	
3.1	Institucionet e BE-së dhe proceset vendimmarrëse , 1 semestër,	2*15*1*0.05=1.5
3.2	Unioni Evropian dhe globalizmi , 2 semestra	2*15*2*0.05=3
3.3	Mediat globale , 1 semestër	2*15*1*0.05=1.5
3	<i>Konsultime me studentë</i>	Pikët
4.1	Hyrje në shkencat politike , 5 semestra	10*5*0.002=0.1
4.2	Integrimet evropiane , 5 semestra	10*5*0.002=0.1
4.3	Studimet evropiane , 4 semestra	10*4*0.002=0.08
4.4	Analiza e politikës së jashtme , 5 semestra	10*5*0.002=0.1
4.5	Politika e jashtme e SHBA-së , 1 semestër	10*1*0.002=0.02

5.	Mentor i punimit të diplomës	5 * 0.2 = 1
5.1	Anëtar në mbrojtje të temës së diplomës	1 * 0.2 = 0.2
5.2	Kryetar komisioni në mbrojtje magjistature	1
	Gjithsej	53.6

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
4.	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar	Pikët
4.1.	Fehari Ramadani & Shefik Shehu : Shqipëria e viteve 1901-1905 në sytë e Konsullit Kral (Promemorie mbi Shqipërinë nga fundi i vitit 1901 deri në fillim të vitit 1905), botuar në <i>Përmbledhje punimesh të Konferencës shkencore ndërkombëtare 'Marrëdhëniet e Popullit Shqiptar me Austro-Hungarinë (Austrinë) nga mesi i shekullit XIX deri në ditët tona', Shkup-Prishtinë, 2017</i>	3*0.9=2.7
4.2.	Kushtrim Ahmeti & Shefik Shehu : The Ranking of Higher education institutions in the Republic of North Macedonia-A Mechanism for increasing the quality of education or the violation/restriction of university autonomy?, published in 5th Annual Conference of the Balkan Universities Association <i>Working Papers, Aristotle University of Thessaloniki, April 2019</i>	3*0.9=2.7
4.3.	Shefik Shehu : Democracy Promotion: The Cornerstone of America's Foreign Policy after the Cold War, <i>Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication, Volume 1, Issue ½, pp.26-30</i>	3
4.4	Shefik Shehu & Gjeraqina Leka: Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach, <i>Justicia, Vol. 8, pp.199-206</i>	3*0.9=2.7
4.5	Vullnet Ameti, Sheruze Osmani Ballazhi, Shefik Shehu & Vjollca Memishi Fejza: The Role of Food Processing Company Employers in Increasing Quality in Higher Education, <i>International Journal of Food Technology and Nutrition, Vol.3, No. 5/6, pp.9-14, 2020</i>	3*0.6=1.8
4.6	Shefik Shehu & Gjeraqina Leka: Gjuha e urrejtjes: një pasqyrim normativ (në botim), Botim i veçantë në kuadër të projektit hulumtues: Hate speech during the campaign of	3*0.9=2.7

	the 2020 parliamentary elections in the RNM: perceived effects on the behaviour of citizens in intergroup relations, Universiteti i Tetovës, 2020	
	Ligjërime plenare në konferencë shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare	
5.1	The Euro-Atlantic Values in the Balkan Countries , pjesëmarrës, organizuar nga Fakulteti për siguri, Universiteti Kliment Ohridski, Ohër-23 shtator 2020	2
5.2	The Ranking of Higher Education Institutions in the Republic of North Macedonia-a mechanism for increasing the quality of education or the violation/restriction of University autonomy , prezantuar në: 5th Annual Conference of the Balkan Universities Association-UN 2030 Sustainable Development Goals in the Balkan Region-the Role of the Universities, Aristotle University of Thessaloniki, 16-18 prill, 2019 Selanik, Greqi	2
5.3	A New Defense Pact for Europe , prezantuar në konferencën 2nd Annual International Conference <i>Global Problems & Community Praxis: Local, National, and International Approaches to Peace and Transcultural Communication</i> , April 19, 2018 Northern Illinois University, Çikago, SHBA	2
5.4	PESCO and the future of EU security , prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare: The Balkans in the European Integration - Past, Present and Future, Universiteti i Sofjes Shën Kliment Ohridski, 16-18 maj 2018, Sofje, Bullgari	2
5.5	Marshall Center Alumni Security Forum ; Ohër, Maqedonia e Veriut (panelist në sesionin <i>Republic of North Macedonia and Euro-Atlantic Integrations: Failures, Achievements and Perspectives</i>) 24-26 gusht 2019, Ohër	2
5.6	Marshall Center Security Forum Transnational Security Threats: Regional and National Contribution to the Regional Security ; Ohër, Maqedonia e Veriut (panelist në sesionin: Euro-Atlantic Response to Emerging Security Threats: Common Transatlantic Response to Diverse Transnational Threats) 17-21 shtator 2018, Ohër	2
5.7	Bologna Process Anniversary , University of Bologna, Italy, 24-25 qershor 2019	2
5.8	Small States' Security Through International Integrations: A Theoretical Approach , prezantuar në: 6th International Scientific Conference of Law "European Perspective of the Western Balkans", Universiteti i Tetovës, 13-15 nëntor 2019	2
5.9	Shqipëria në sytë e Konsullit Kral 1901-1905 ,	2

	prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Marrëdhënia e Shqiptarëve me Austro-Hungarinë (Austrinë) nga mesi i shekullit XIX deri në ditët tona, UBT, 9 shtator 2016, Prishtinë, Kosovë	
5.10	Democracy Promotion: The Cornerstone of America's Foreign Policy After the Cold War prezantuar në The Impact of US Policy in Promoting Democracy, Peace, State-Building, Economic Recovery and the Protection of National, Religious and Civic Values in the Countries of the Region, Universiteti i Tetovës & Northern Illinois University, 15 Dhjetor 2016	2
5.11	The Strategic Culture of the European Union: From the European Security Strategy to the Global Strategy of the EU , prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore The Law and Challenges of the Euro-Atlantic Processes, Faculty of Law, Universiteti i Tetovës, 18-19 nëntor 2016, Tetovë	2
5.12	The European Union's security nexus: A constructivist approach , prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Universality, Globalization and the Rule of Law, Universiteti i Tetovës, 13-14 nëntor 2015, Tetovë	2
5.13	Turkish Foreign Policy Under the Justice and Development Party's Rule , prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process, Universiteti i Tetovës, 17-18 nëntor 2017	2
5.14	EU Foreign Policy in Times of Populism , organizuar nga Akademia Diplomatike e Vienës në kuadër të COST projektit CA17119, Vienë, Austri	2
	Pjesëmarrës në projekt shkencor ndërkombëtar	
6.1	COST projekti: CA17119: EU Foreign Policy Facing New Realities: Perceptions, Contestation, Communication and Relations (anëtar nga RMV) 2019-vijon	5
6.2	Hate speech during the campaign of the 2020 parliamentary elections in the RNM: perceived effects on the behaviour of citizens in intergroup relations, 2020	5
6.3	Koordinator universitar në rrjetin CEPUS: CZ-0311, 2018-vijon	9
6.4	Peace Education's impact on relationship building and societal conflicts. Project period: 2014-01-01—2016-12-31. Supported by the Swedish Research Council (VR)	5
	Gjithsej	67.6

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. Rendor	Emri aktivitetit:	Pikët
7.	Koordinator për përgatitjen e elaboratit të programit studimor	
7.1.	Studime Politike (cikli parë)	2
7.2.	Studime Politike (cikli dytë)	2
7.3	Studime të doktoraturës në Fakultetin Juridik	2
7.4	Trajnues në trajnimin “ Teachers of Tomorrow ”, organizuar nga ForumZfD Prishtinë, përmes platformës ZOOM. Moduli i trajnimit: Multiperspektiviteti dhe Kultura e Mbamendjes, 19 nëntor 2020	1
7.5	Trajnues në trajnimin e organizuar nga Komisioni për mundësi të barabarta, Komuna e Strugës, në temë: Lufta ndaj diskriminimit në një shoqëri demokratike, 15 nëntor 2019	1
7.6	Trajnues në Shkollën Verore Challenge History organizuar nga ForumZfD Bosnjë dhe Hercegovinë, Mostar, 16-21 korrik 2017	1
7.7	Trajnues në trajnimin për trajner për përdorimin e instrumentit pedagogjik mbi kulturën e kujtesës “MemorInmotion” (kujtesa në lëvizje), organizuar nga ForumZfD Bosnjë dhe Hercegovinë & ForumZfD Prishtinë dhe EUROCLIO HIP BiH, 26 nëntor 2016, Prishtinë	1
7.8	Trajnues në trajnimin për trajner për përdorimin e instrumentit pedagogjik mbi kulturën e kujtesës “MemorInmotion” (kujtesa në lëvizje), organizuar nga ForumZfD Bosnjë dhe Hercegovinë & ForumZfD Prishtinë dhe EUROCLIO HIP BiH, 19-20 nëntor 2016, Shkup	1
8.	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit	Pikët
8.1	Pjesë e ekipit promovues të Universitetit (2015-2020)	1
	Gjithsej	12

VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
9.	Anëtar i këshillit organizues ose programor i tubimit ndërkombëtar shkencor/profesional/vizita studimore/këmbime akademike	Pikët
9.1	Ludvig Maximillian University, University of Ausburg & University of Regensburg, Gjermani, 4-10 nëntor 2018, organizuar nga CBC Loja	1
9.2	Punëtori dhe ligjërata në Universitetin Peradenija, Kandi, Sri Lankë, në kuadër të projektit hulumtues Peace Education's impact on relationship building and societal conflicts, finansuar nga Swedish Reserch Council, 1-8 nëntor 2016	1
9.3	Vizitë pune në Universitetin Mehmet Akif Ersoj, Burdur, Turqi 1-3 nëntor 2017	1
9.4	Këmbim akademik Erasmus +, në Lithuania Business University of Applied Sciences, Klaipeda, Lituani, 4-7 shtator 2018	1
9.5	Vizitë pune në Alexander Technological Educational Institute (ATEI), Selanik, 17 prill 2018	1
10.	Udhëheqës	Pikët
10.1.	Zyra për Menaxhimin dhe Përpilimin e Projekteve (2017-2019)	3
10.2.	Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar (2019-)	7
11	Anëtar i komisionit universitar	Pikët
11.1	Komisioni për regjistrim të studentëve në ciklin e parë (2019-2020)	1
11.2	Komisioni për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë (2019-2020)	1
11.3	Komisioni qendror për regjistrimin e studentëve në ciklin e parë (2020/2021)	1
11.4	Komisioni qendror për regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë (2020/2021)	1
11.5	Prezantimi i ofertës akademike 2016/2017/2018/2019/2020	5
11.6	Komisioni universitar për evaluim dhe cilësi	1
	Kryetar	Pikët
12.1	Kryetar i komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar	3
12.2	Kryetar i komisionit për përpilim e elaboratit për ciklin II të Shkencave Politike	3
	Gjithsej	31

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN	Pikët
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	53.6
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	67.6
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	12
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	31
Gjithsej	164.2

Tetovë, më 23 dhjetor 2020

Anëtarët e komisionit recensues:

Prof. Dr. Ylber Sela (kryetar)

Prof. Dr. Mersim Maksuti (anëtar)

Prof. Dr. Bashkim Selmani (anëtar)
